



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 616 prot.

Tiranë, më 26.05.2020

V E N D I M

Nr. 52, Datë 26.05.2020

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 162, datë 30.12.2019, e shtetasit B. P., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve¹, në të cilën pretendohet për diskriminim *për shkak të bindjeve politike*².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

B. P. në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka mbajtur detyrën e Inspektorit të Kontrollit në Sektorin e Verifikimit në Terren, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatim paguesve të Mëdhenj. Me vendimin nr. 598, datë 24.07.2015, Komisioni i Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka vendosur: *“Marrjen e masës disiplinore ‘Largim nga Shërbimi Civil’”, për B. P. Duke mos qënë dakord me këtë vendim, B. P. i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt: “Shfuqizimin e Aktit Administrativ ‘vendim nr. 598, datë 24.07.2015 të Komisionit të Disiplinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, dhënien e të gjitha pagave nga data e shkëputjes deri në fillimin e marrëdhënieve të punës”.* Me vendimin nr. 5541, datë 03.11.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur *“Pranimin e plotë të kërkesë padisë”.* Kundër këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, e cila me vendim nr. 1338, datë 02.05.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në vijim, ankuesi me anë të Shoqërisë Përmbarimore “B.S.E. Bailiff

¹ Në vijim DPT.

² Mbështetur në Taserën e Anëtarit Nr. K 123, datë 23.03.1991

service executive” shpk, ka kërkuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve zbatimin dhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, por nuk është realizuar. Sipas ankuesit, ky mosveprim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për mos ekzekutimin e vendimit të gjykatës, ka ardhur si rezultat i bindjeve politike të tij, si anëtar i Partisë Republikane të Shqipërisë.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, B. P. ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminimin e tij nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, përmes mosekzekutimit të vendimit nr. 5541, datë 03.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 1338, datë 02.05.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Me anë të shkresës Nr. 52 prot., datë 13.01.2020, i është drejtuar subjektit ndaj të cilit është paraqitur ankesa dhe ka kërkuar informacion⁴, si dhe parashtrime rreth pretendimeve të ngritura nga ana e B. P.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën⁵ Nr. 592/1 prot., datë 28.01.2020, informoi ndër të tjera se: *“...Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në zbatim të Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike ‘Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil’, ka ngritur Komisionin e Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Administrata Tatimore, të riformatuar sipas ndryshimeve strukturore. Komisioni i Posaçëm, në mënyrë të vazhdueshme, në zbatim të veprimtarisë së tij, shqyrton kërkesat e gjyqfitesve së bashku me dokumentacionin ligjor, për ekzekutim të vendimeve të formës së prerë, duke analizuar kriteret specifike dhe të përgjithshme të pozicioneve të vendeve vakante, llojin e diplomës, eksperiencën në pozicionet e mëparshme të punës, kategoritë e pagave, në momentin e largimit nga shërbimi civil të gjyqfitesve, në zbatim të dispozitivit të vendimeve të formës së prerë. Më Urdhërin nr. 64, datë 14.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është ngritur grup pune me përfaqësues nga tre drejtori, për verifikimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të rregjistruara për praktikantët në proces ekzekutimi. Grupi i punës ka hartuar databazë të renditura sipas datës së depozitimit të praktikës gjyqësore të DPT. Në zbatim të dispozitave ligjore dhe praktikës, praktika e plotë gjyqësore e gjyqfitesve, plotësohet dhe përcillet për procedura të mëtejshme, nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike. Referuar shkresës nr. 11880/1 prot., datë 20.06.2019, rezulton se praktika gjyqësore, është përcjellë e plotë për ekzekutim, nga Drejtoria Ligjore Teknike, në datë 20.06.2019. Sqarojmë se, Komisioni i Posaçëm në bashkëpunim dhe konsultim me Departamentin e Administratës Publike, nisur nga fakti i depozitimit të praktikave gjyqësore, ndër vite, në vazhdimësi të shqyrtimit të kërkesave, merr në konsideratë dhe momentin/vitin e zbardhjes së vendimit të formës së prerë. Aktualisht, Komisioni i Posaçëm, është duke shqyrtuar praktikantët gjyqësore, të përcjella për procedura ekzekutimi, përpara vitit 2019, si dhe për të cilat titulli ekzekutiv është i periudhave përpara vitit 2019. Pra, nga momenti i përcjelljes së praktikës gjyqësore të plotë të B. P., datë 20.06.2019, bëjmë me dije se, nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike, janë përcjellë edhe 7 (shtatë) praktika të tjera gjyqësore, të cilat sipas kronologjisë së shqyrtimit të praktikave gjyqësore, nga Komisioni i Posaçëm, asnjë nuk është marrë në shqyrtim. Komisioni i Posaçëm, në mbledhjet e radhës, do të shqyrtojë të gjitha praktikantët gjyqësore, në të cilat përfshihet praktika gjyqësore e B. P. Lidhur me pretendimin e B.*

⁴ - Informacion mbi pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e B. P.

- Informacion dhe kopje të dokumentacionit nëse është kryer ekzekutimi i vendimeve nr. 5541, datë 03.11.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe nr. 1338, datë 02.05.2019, të Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë, për rastin e B. P. Nëse jo, arsyet e mos ekzekutimit të tyre.

- Informacion nëse ka persona të tjerë në kushtet e B. P., të cilët kanë përfituar ekzekutimin e vendimeve gjyqësore lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me DPT-në. Nëse po, informacion rreth tyre dhe kopje të dokumentacionit provues.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 178 prot., datë 29.01.2020

P., për diskriminimin e tij për shkak të bindjeve politike, bëjmë me dije se ky pretendim nuk qëndron dhe është totalisht i pabazë, pasi, në asnjë deklaratë paraprake të bërë kryesisht nga B. P., Komisioni i Posaçëm, apo edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nuk është vënë në dijeni lidhur me bindjet politike dhe nuk ka kërkuar asnjëherë një informacion të tillë.”

Në përfundim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka vënë në dispozicion të Komisionerit një kopje të shkresës përcjellëse të Drejtorisë Ligjore dhe Teknike të DPT-së, drejtuar Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës, lidhur me praktikën e B. P.

- Në vijim të procedurave, ankuesi me anë të shkresës⁶ datë 30.01.2020, informoi Komisionerin ndër të tjera se: “...me anë të Shoqërisë Përmbarimore “B.S.E. Bailiff service executive” shpk, ka kërkuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve zbatimin dhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, por nuk është realizuar. Sipas ankuesit, ky mosveprim i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mos ekzekutimin e vendimit të gjykatës, ka ardhur si rezultat i bindjeve politike të tij, si anëtarë i Partisë Republikane të Shqipërisë.”

Gjithashtu, në përfundim të informacionit të dhënë në shkresën e sipërcituar, ankuesi sqaron se në rrugë verbale ka marrë dijeni se, për shtetasin E. V. (sipas tij person i cili ndodhet në të njëjtat kushte me të), është bërë ekzekutimi i vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së B. P., Komisioneri me shkresën Nr. 356 prot., datë 28.02.2020, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 10.03.2020 duke kërkuar shpjegime shtesë.

Në përfundim, është kërkuar nga ana e **Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve**, të vënë në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore:

- Informacion nëse ka persona të tjerë në kushtet e B. P., të cilët kanë përfutur ekzekutimin e vendimeve gjyqësore lidhur me zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me DPT-në. Nëse po, informacion rreth tyre dhe kopje të dokumentacionit provues.

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 231 prot., datë 06.02.2020

- Kopje të Urdhërit nr. 64, datë 14.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, për ngritjen e grupit të punës, për verifikimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të rregjistruara për praktikantët në proces ekzekutimi.
- Kopje të informacionit të databazës, që ka ngritur DPT, lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Kjo, për qëllim analizimin e tij lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, kronologjinë e tyre dhe mënyrën e ekzekutimit.
- Informacion nëse është bërë ekzekutimi i vendimit gjyqësor për shtetasin E. V., të pretenduar nga ana e ankuesit.

Seanca u zhvillua në datën 10.03.2020, me praninë e palëve: subjektit ankues⁷ dhe përfaqësuesve⁸ të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të rregjistrohej dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

Në vijim të seancës dëgjimore ankuesi thaksoi se pavarësisht vendimit të formës së prerë të marrë nga ana e Gjykatës së Apelit Administrativ, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për rikthimin e tij në punë apo për dëmshpërblimin e caktuar nga gjykata. Sipas tij, DPT me anë të veprimeve dhe mosveprimeve ka diskriminuar atë për shkak të bindjeve politike në raport me persona të tjerë, të cilët ndodhen në të njëjtat kushte. Gjithashtu, u theksua se paravësisht faktit që nga ana e ankuesit nuk janë shfaqur ndonjëherë bindjet politike dhe anëtarësia në subjektin politik Partia Republikane, ai është është trajtuar ndryshe në raport me shtetasin E. V.

Në përgjigje të pretendimeve të ngritura nga ana e subjektit ankues, përfaqësueset e DPT-së theksuan faktin se pretendimet e tij nuk qëndrojnë, pasi sa i përket shtetasit E. V., është i vërtetë fakti që ai është kthyer në punë, pranë DPT-së, por nuk është në të njëjtat kushte me ankuesin. Shtetasi E. V., është kthyer në punë në vitin 2017, referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ të po të njëjtit vit, rreth dy vite përpara ankuesit, si dhe në momentin që gjykata është shprehur vendi i punës së tij ishte vakant. Në këtë mënyrë ai është ekzekutuar në të njëjtin vit që ka dalë edhe vendimi i gjykatës. Ndërsa, sa i përket ankuesit, për shkak të ndryshimeve të strukturës së DPT-së, pozicioni që ka mbajtur më parë nuk ekziston dhe kjo është arsyeja përse vendimi i gjykatës nuk është ekzekutuar ende. Gjithashtu, u theksua se Komisioni i Posaçëm i DPT-së, aktualisht ka në proces shqyrtimi rreth 143 praktika, ku bën pjesë edhe ajo e ankuesit, të

⁷ I cili ishte në praninë edhe të përfaqësueses së tij ligjore shtetases Ç. E.

⁸E. P., me detyrë Përgjegjëse në Sektorin e Rekrutimit dhe Promovimit në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe E. B., Specialiste në të njëjtin Sektor, me autorizim Nr. 5096 prot., datë 06.03.2020

cilat datojnë nga viti 2007 e në vijim. Ky Komision trajton në mënyrë të vijueshme të gjithë praktikatat dhe sipas procedurës që ka ndjekur deri në këto momente, fillimisht merret si kriter viti i gjyqfituesve, e më pas nëse ata janë të punësuar. Në këtë kuptim, nëse një gjyqfitues është i punësuar në një institucion tjetër dhe për të ulur dëmin ekonomik, pasi deri në momentin e rikthimit në detyrë ai përfiton pagën, Komisioni propozon më parë rikthimin e tyre në detyrë.

Shtetasi E. V., është larguar nga Shërbimi Civil në të njëjtin vit me ankuesin, në vitin 2015. Në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës E. V. ka mbajtur pozicionin e Inspektorit të Parë në Sektorin e Kontrollit Tatimor, pozicion i cili nuk është suprimuar. Ndërsa ankuesi, ka qënë në strukturat e Verifikimit në Terren pranë Drejtorisë së Tatimpaguesve të Mëdhenj, si Inspektor në Sektorin e Verifikimit në Terren, pozicion i cili është suprimuar. E. V. është rikthyer tashmë në pozicionin e mëparshëm të punës, pra Inspektor Kontrolli në Drejtorinë Rajonale Tiranë. Vendimi i gjykatës së formës së prerë për shtetasin E. V. është marrë në vitin 2017, ndërsa për ankuesin në vitin 2019.

Sipas përfaqësueseve të DPT-së, pas largimit të tij, ky pozicion nuk është shpallur asnjëherë vakant. Aktualisht pozicioni i B. P. nuk ekziston në strukturën organizative të DPT-së, pasi nga largimi i tij nga puna e deri më datë 10.03.2020, administrata Tatimore qendrore ka kaluar 4 procedura ristrukturimi. Pra, këto procedura ristrukturimi janë kryer në zbatim të urdhërit të Kryeministrit për ndryshimin e strukturës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Strukturat e Verifikimit në Terren, në të cilën ka qënë pjesë ankuesi, janë suprimuar në vitin 2016, me Urdhërin Nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e përgjithshëm të personelit në administratën tatimore qendrore”*. Pra, rikthimi dhe ekzekutimi i vendimit të gjykatës për ankuesin do të bëhet në momentin që do të gjendet një pozicion i lirë pune që përshtatet me kategorinë e pagës, arsimin e tij, etj.

Në përfundim nga ana e përfaqësueseve të DPT-së u theksua se aktualisht nuk është bërë ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë të gjykatave, për asnjë gjyqfitues për vitin 2019. Pra, nga ana e Komisionit të Posaçëm, nuk është marrë në shqyrtim asnjë nga praktikatat e gjyqfituesve të vitit 2019, e jo më të jetë bërë rikthimi në detyrë.

- Pas seancës dëgjimore, me anë të shkresës⁹ Nr. 4735/1 prot., datë 24.03.2020, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, i ka përcjellë KMD-së:
 - Kopje të Urdhërit Nr. 126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, së bashku me strukturën organizative të DTM;
 - Kopje të Urdhërit Nr. 49 datë 27.02.2019, të Kryeministrit, së bashku me strukturën organizative të DTM;
 - Kopje të Urdhërit Nr. 86, datë 03.05.2016, të Kryeministrit, së bashku me strukturën organizative të DTM;

⁹ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 501 prot., datë 06.04.2020

- Praktika gjyqësore e përcjellë nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike, për B. P., nr. 11880/1 prot., datë 20.06.2019;
- Dokumentacion mbi gjyqfituesin E. V.;
- Praktika gjyqësore të përcjella nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike, pas momentit të përcjelljes së praktikës gjyqësore, për ekzekutimin, të B. P.;

Në përfundim, nga ana e DPT-së, u sqarua ndër të tjera se: *“...në vitin 2019, janë 16 praktika gjyqësore të ekzekutuara nga DPT, të cilat mbanin vendime gjyqësore të formës së prerë, përpara vitit 2019, vit në të cilin gjykata kompetente është shprehur me vendim gjyqësor të formës së prerë, mbi kërkesë padinë e B. P.”*.

Gjatë shqyrtimit të këtij ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Mbështetur në provat e administruara ankuesi ka filluar punë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në vitin 2006. Në momentin e marrjes së vendimit për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, ankuesi ka mbajtur pozicionin e Inspektorit në Sektorin e Verifikimit në Terren, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë. Me shkresën Nr. 20353/2 prot., datë 08.07.2015, ai është njoftuar nga ana e DPT-së për fillimin e ecurisë disiplinore. Në përfundim, me vendimin nr. 598, datë 24.07.2015, Komisioni i Disiplinës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka vendosur: *“Marrjen e masës disiplinore ‘Largim nga Shërbimi Civil’”, për B. P. Duke mos qënë dakord me këtë vendim, B. P. i është drejtuar me kërkesë padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt: “Shfuqizimin e Aktit Administrativ ‘vendim nr. 598, datë 24.07.2015 të Komisionit të Disiplinës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, kthimin në pozicionin e mëparshëm të punës, dhënien e të gjitha pagave nga data e shkëputjes deri në fillimin e marrëdhënieve të punës”*. Me vendimin nr. 5541, datë 03.11.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur *“Pranimin e plotë të kërkesë padisë”*. Kundër këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, e cila me vendim nr. 1338, datë 02.05.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në vijim, ankuesi me anë të Shoqërisë Përmbarimore *“B.S.E. Bailiff service executive”* shpk, ka kërkuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve zbatimin dhe ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ, por nuk është realizuar. Me datë 11.06.2019, zyra përmbarimore i është drejtuar DPT-së me shkresën Nr. 20 rregj., Nr. 98 prot. *“Lajmërim për ekzekutim vullnetar”*. Duke qënë se nga ana e DPT-së nuk kishte patur asnjë reagim, zyra

përmbartim i është drejtuar sërish më datë 03.07.2019 dhe me vendimin *“Për fillimin e ekzekutimit të detyrueshëm”* Nr. 20 rregj., Nr. 120 prot. Gjithashtu më datë 19.09.2019, zyra përmbartim i është drejtuar degës së thesarit, me anë të Urdhërit Nr. 20 rregj., Nr. 170 prot., *“Për vënien e sekuestros konservative”* së fondeve buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga palët në proces, në vijim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, në zbatim të Urdhërit nr. 5151, datë 28.10.2015 të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike *“Për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës publike, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”*, ka ngritur Komisionin e Posaçëm për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga Administrata Tatimore, të riformatuar sipas ndryshimeve strukturore. Ky Komision, në zbatim të veprimtarisë së tij, shqyrton kërkesat e gjyqfituesve së bashku me dokumentacionin ligjor, për ekzekutim të vendimeve të formës së prerë, duke analizuar kriteret specifike dhe të përgjithshme të pozicioneve të vendeve vakante, llojin e diplomës, eksperiencën në pozicionet e mëparshme të punës, kategoritë e pagave, në momentin e largimit nga shërbimi civil të gjyqfituesve, në zbatim të dispozitivit të vendimeve të formës së prerë.

Me Urdhërin nr. 64, datë 14.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, është ngritur grup pune me përfaqësues nga tre drejtori, për verifikimin, saktësimin dhe përditësimin e të dhënave të regjistruara për praktikantët në proces ekzekutimi. Grupi i punës ka hartuar databazë ku janë renditur gjyqfituesit sipas datës së depozitimit të praktikës gjyqësore të DPT. Në zbatim të këtij urdhëri, praktika e plotë gjyqësore e gjyqfituesve, plotësohet dhe përcillet për procedura të mëtejshme, nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike.

Përsa më sipër, referuar shkresës nr. 11880/1 prot., datë 20.06.2019, rezulton se praktika gjyqësore e B. P., është përcjellë për ekzekutim, nga Drejtoria Ligjore Teknike, në datë 20.06.2019.

Referuar rastit të cilin ankuesi e ka bërë prezent përpara Komisionerit dhe pretendon se në raport me të është trajtuar në mënyrë të pabarabartë, evidentohet se Komisioni i Posaçëm në bashkëpunim dhe konsultim me Departamentin e Administratës Publike, ka kryer procedurën e rikthimit në punë të shtetasit E. V. Nga provat e administruara, rezulton se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, pasi është vënë në dijeni të vendimit të formës së prerë për shtetasin E. V., pasi ka marrë miratimin e tij, i ka propozuar Departamentit të Administratës Publike, emërimin në një nga pozicionet vakante që i përshtatej. Më pas referuar shkresës Nr. 6688/2 prot., të muajit dhjetor 2017, shtetasi E. V. është emëruar në pozicionin e punës që i përshtatej me llojin e diplomës, eksperiencën në punë dhe kategorinë e pagës në momentin e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

Pra, sipas informacionit të administruar, Komisioni i Posaçëm në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, bëjnë emërimin e punonjësve, nisur nga fakti i

depozitimit të praktikave gjyqësore, ndër vite, në vazhdimësi të shqyrtimit të kërkesave, si dhe merr në konsideratë dhe momentin/vitin e zbardhjes së vendimit të formës së prerë.

Sipas informacionit të vënë në dispozicion, Komisioni i Posaçëm, gjatë vitit 2019-2020, ka shqyrtuar praktikat gjyqësore, të përcjella për procedura ekzekutimi, përpara vitit 2019, si dhe për të cilat titulli ekzekutiv është i periudhave përpara vitit 2019. Në këtë kuptim nga ana e Komisionit të Posaçëm janë përcjellë për ekzekutim, praktikat e shtetasve:

- M. D., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 2250, datë 24.05.2017;
- A. N., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 1676, datë 19.04.2018;
- B. H., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 2650, datë 27.06.2018;
- R. Ç., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 1536, datë 18.11.2009;
- M. G., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 1384, datë 03.04.2018;
- A. K., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 4468, datë 14.12.2018;
- A. B., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 916, datë 06.03.2018;
- A. N, në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 2002, datë 15.05.2018;
- A. K., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 3729, datë 09.11.2016;
- F. M., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 1130, datë 08.06.2015;
- A. M., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 1847, datë 10.09.2015;
- A. M., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 5542, datë 26.12.2017;
- M. H., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 2135, datë 17.05.2017;
- M. S., në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit nr. 588, datë 20.03.2008.

Nga informacioni i sipërcituar, evidentohet se Komisioni i Posaçëm ka përcjellë praktikat gjyqësore për ekzekutim, të cilat datojnë nga viti 2008 deri në vitin 2018. Pra, konstatohet se Komisioni i Posaçëm nuk ka marrë në shqyrtim asnjë praktikë për të cilën Gjykata e Apelit Administrativ është shprehur në vitin 2019, kohë kur është marrë vendimi edhe për B. P.

Në zbatim të Urdhërit nr. 64, datë 14.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, sa i përket praktikave gjyqësore, Drejtoria Ligjore dhe Teknike e DPT-së ka përcjellë pranë Komisionit të Posaçëm, që nga momenti i dorëzimit të praktikës së ankuesit edhe 6 praktika të tjera, si më poshtë:

- Me shkresën Nr. 11880/1 prot., datë 20.06.2019, është përcjellë për kompetencë praktika e shtetasit B. P.
- Me shkresën Nr. 12666/1 prot., datë 09.07.2019, është përcjellë për kompetencë praktika e shtetases R. A.
- Me shkresën Nr. 14907/1 prot., datë 13.08.2019, është përcjellë për kompetencë praktika e shtetases P. R.
- Me shkresën Nr. 14417/3 prot., datë 03.09.2019, është përcjellë për kompetencë praktika e shtetasit N. C.
- Me shkresën Nr. 19228/3 prot., datë 18.11.2019, është përcjellë për kompetencë praktika e shtetases L. S.
- Me shkresën Nr. 20199/3 prot., datë 27.11.2019, është përcjellë për kompetencë praktika e shtetases S. N.
- Me shkresën Nr. 21906/2 prot., datë 23.12.2019, është përcjellë për kompetencë praktika e shtetasit N. K.

Në analizë të veprimeve të sipërcituara dhe në zbatim të Urdhërit nr. 64, datë 14.10.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, evidentohet se Drejtoria Ligjore dhe Teknike, pas shqyrtimit ka dërguar në Komisionin e Posaçëm praktikën gjyqësore për trajtim të mëtejshëm, siç ka bërë edhe me praktikën e ankuesit. Pra, konstatohet se për ankuesin edhe për gjyqfituesit e tjerë, është ndjekur e njëjta rrugë ligjore nga ana e Drejtorisë Ligjore dhe Teknike.

Gjithashtu, konstatohet se Komisioni i Posaçëm gjatë vitit 2019-2020, nuk ka marrë në shqyrtim asnjë praktikë për të cilën vendimi i formës së prerë apo Gjykata e Apelit Administrativ të jetë shprehur në vitin 2019, kohë kur është marrë vendimi edhe për B. P. Pra, në këtë rast konstatohet se ankuesi nuk është në të njëjtat kushte me gjyqfituesit e sipërpërmendur të rikthyer në punë, për të cilët gjykata është shprehur me vendim të formës së prerë gjatë viteve 2008-2017.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin*

çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimit dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, rezulton se ankuesi nuk është në të njëjtat kushte me shtetasin E. V., me të cilin pretendon se është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe diskriminuese. Gjithashtu, nuk rezulton se ka patur gjyqfitues të tjerë në të njëjtat kushte me ankuesit, të cilët të jenë rikthyer në punë, apo për ta të jetë zbatuar vendimi i formës së prerë. Në këtë kuptim, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të padrejtë apo të pafavorshëm të subjektit ankues nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankuesit, ose që kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm e të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetasit B. P. nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shkak të “bindjes politike”.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)